

# RRUGËT REGIONALE DHE LOKALE TË KOSOVËS VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

## Korniza për sigurim të tokës



Republika e Kosovës  
Ministria e Infrastrukturës

Përfundimtar  
05 Janar 2016



# RRUGËT REGJIONALE DHE LOKALE TË KOSOVËS VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

## Korniza për sigurim të tokës

<b>Projekti:</b>	Rrugët regjionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësimi mjedisor dhe social
<b>Raporti:</b>	Korniza për sigurim të tokës
<b>Përgatitur nga:</b>	Ministria e infrastrukturës
<b>Financuar nga:</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>Konsulenti:</b>	Enova d.o.o.Sarajevë

## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>HYRJA</b> .....	<b>4</b>
1.1	PËRSHKRIMI DHE KONTEKSTI I PROJEKTIT .....	4
1.2	FUSHËVEPRIMI I DOKUMENTIT .....	4
<b>2</b>	<b>KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR SIGURIM TË TOKËS</b> .....	<b>5</b>
2.1	KORNIZA INSTITUCIONALE PËR SIGURIM TË TOKËS NË KOSOVË .....	5
2.1	KORNIZA LIGJORE PËR SIGURIM TË TOKËS NË KOSOVË.....	5
2.2	LEGJISLACIONI TJETËR I NDËRLIDHUR I KOSOVËS .....	8
2.3	POLITIKA NË FUQI E BERZH-IT .....	9
2.4	MANGËSITË DHE ZGJIDHJET .....	9
<b>3</b>	<b>NDIKIMET E PROJEKTIT</b> .....	<b>12</b>
3.2	STATUSI AKTUAL I PROJEKTIT DHE PROCESI I PLANIFIKUAR I EKSPROPRIJIMIT .....	12
<b>4</b>	<b>PARIMET DHE ÇËSHTJET KYÇE TË MARRJES SË TOKËS / KOMPENSIMIT</b> .....	<b>14</b>
<b>5</b>	<b>TË DREJTAT NË KOMPENSIM</b> .....	<b>16</b>
<b>6</b>	<b>SHPALOSJA E INFORMATAVE DHE KONSULTIMET PUBLIKE</b> .....	<b>17</b>
<b>7</b>	<b>ZBATIMI I KST</b> .....	<b>19</b>
7.1	PËRGJEGJËSITË PËR ZBATIM .....	19
7.2	KOSTOT .....	19
7.3	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	19
<b>8</b>	<b>MEKANIZMI I ANKESAVE</b> .....	<b>21</b>
	<b>SHTOJCA 1: MOSTRA E KORNIZËS PËR KST</b> .....	<b>22</b>
	<b>SHTOJCA 2: GRAFIKU I RRJEDHËS PËR PROCEDIMIN E ANKESAVE</b> .....	<b>23</b>
	<b>SHTOJCA 3: FORMULARI I ANKESËS PUBLIKE</b> .....	<b>24</b>

## 1 HYRJA

### 1.1 Përshkrimi dhe konteksti i projektit

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është duke shqyrtuar sigurimin e financimit për Ministrinë e infrastrukturës së Kosovës (Ministria) në mbështetje të punëve për përmirësim të rrugëve kombëtare në kuadër të "Projektit të rrugëve regjionale dhe lokale të Kosovës" (Projekti).

Projekti synon zgjerimin në katër korsi të rrugëve hyrëse/dalëse në komunat Gjilan, Ferizaj dhe Prizren dhe rehabilitimin e pjesës së rrugës Kllokot – Gjilan. Këto pjesë konsiderohen si projekte prioritare në kuadër të *Strategjisë së transportit multimodal* (2012-2021) dhe *Planit të Veprimit* (2012-2016) të Kosovës.

**Seksioni N25-2 i rrugës për qasje në Gjilan** është rrugë kryesore hyrëse në komunën e Gjilanit nga drejtimi i kryeqytetit të vendit, Prishtinës, dhe lidhja më e shpejtë me autostradën A1 në Republikën e Serbisë. Ky seksion është një degë e rrjetit kryesor kombëtar dhe regjional të rrugëve të Kosovës.

**Seksioni N2 i rrugës për qasje në Ferizaj** është lidhja më e shpejtë me Shkupin në Maqedoni nga drejtimi i kryeqytetit të vendit, Prishtinës, përmes komunës së Ferizajit. Kjo do të jetë rrugë tranziti për autostradën e ardhshme R6 Prishtinë - Shkup, aktualisht në ndërtim e sipër, me datën e pritur të përfundimit në vitin 2018.

**Seksioni R107 i rrugës për qasje në Prizren** është një rrugë e rëndësishme e qasjes në komunën e Prizrenit nga drejtimi i Gjakovës, e cila vepron si një ndërlidhje ndërmjet qyteteve kryesore në Kosovë.

**Seksioni N25 – 3 Kllokot – Gjilan** rindërtimi i asfaltit në rrugën automobilistike e cila fillon në udhëkryqin nga Kllokoti nëpër Magjistralen N 25- 3 dhe përfundon në tranzitin e Gjilanit. Ka rëndësi të madhe dhe lidh komunat e Gjilanit, Parteshit, Kllokotit dhe Ferizajit.

Më shumë informata lidhur me fushëveprimin dhe dobitë e Projektit, ndikimet e pritura mjedisore dhe sociale si dhe masat e planifikuara të zbatimit dhe monitorimit janë dhënë në Përmbledhje jo-teknike, të shpalosur publikisht në kuadër të Projektit, si pjesë e pakos së shpalosjes.

### 1.2 Fushëveprimi i dokumentit

Ministria për infrastrukturën e Kosovës (Ministria), si agjenci për zbatimin e Projektit, ka përgatitur këtë **Kornizë për sigurim të tokës (KST) me synim pasqyrimin e parimeve të përgjithshme, procedurave si dhe kornizës së të drejtave** në lidhje me ndikimet e mundshme nga sigurimi i tokës së nevojshme për Projekti, në përputhje me ligjet në fuqi në Kosovë dhe me kërkesat e BERZH-it, në veçanti me Kërkesat e BERZH-it për performancës (KP) 5 të Politikës mjedisore dhe sociale të BERZH-it (2014)<sup>1</sup>: *Sigurimi i tokës, zhvendosja e detyrueshme dhe zhvendosja ekonomike*.

Kjo KST shërben si bazë për zhvillimin e Planeve të detajshme të sigurimit të tokës (PST) për Projektin, të cilët do të hartohen pasi të përcaktohen natyra e saktë dhe përmasat e sigurimit të tokës apo kufizimeve në përdorim të tokës të ndërlidhura me Projektin, gjegjësisht pas hartimit të studimeve të eksproprijimit që kërkohen me legjislacion të vendit (deri në prill 2016, sipas vlerësimeve aktuale). Planet do të ofrojnë detaje më të sakta lidhur me Njerëzit e Prekur nga Projekti, kriteret e pranueshmërisë si dhe procedurat që do të aplikohen për Projektin në përputhje me këtë KST dhe në përputhje me KP5 të BERZH-it.

**Mostra e një pasqyre të tillë me shënime gjegjëse për KST është dhënë në Aneksin 1 të këtij dokumenti.**

<sup>1</sup>Teksti i plotë i Politikës gjendet në: <http://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html>

## 2 Korniza ligjore dhe institucionale për sigurim të tokës

### 2.1 Korniza institucionale për sigurim të tokës në Kosovë

Sigurimi i tokës dhe zhvendosja në Kosovë mund të kryhen nga organe administrative ("organi eksproprijues") në dy nivele:

1. **Komunat** (në rastet kur prona e prekur gjendet në tërësi përbrenda territorit të një komune): Kryetarët e komunave apo ndonjë organ tjetër gjegjësi i komunës veprojnë si autoritet eksproprijues në emër të komunës,
2. **Qeveria e Kosovës** (në rastet kur prona e prekur bie përbrenda territorit të dy apo më shumë komunave): Ministria për mjedis dhe planifikim hapësinor vepron si organ eksproprijues në emër të autoriteteve të nivelit qendror.

Institucionet tjera kyçe të përfshira në procesin e eksproprijimit janë:

- **Zyra për vlerësim të patundshmërive (në kuadër të Departamentit për tatimin në pronë) përbrenda Ministrisë së Financave**, organ i vetëm publik ky i cili është kompetent për vlerësimin e patundshmërive që do të jenë lëndë e eksproprijimit nga autoriteti eksproprijues (komuna apo Qeveria).
- **Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)**, autoriteti më i lartë për kadastrë, gjeodezi dhe hartografi në Kosovë, përgjegjëse për administrimin e *Regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme në Kosovë*.
- **Zyrat komunale të kadastrit**, të cilat duhet të regjistrojnë vendimet e plotfuqishme (në *Regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme*) për eksproprijim të patundshmërive (parashtruar nga autoriteti eksproprijues), në mënyrë që pronarëve apo bartësve të interesit t'u parandalojë bartje apo tjetërsim të të drejtave pronësore apo interesave të tjera në pronën gjegjëse, dhe kryen punë ndërtimore në pronën në fjalë.

### 2.1 Korniza ligjore për sigurim të tokës në Kosovë

#### ***Kushtetuta e Republikës së Kosovës***

Kushtetuta ndalon privim arbitrar nga prona (Neni 46) – autoritetet mund të eksproprijojnë pronë vetëm nëse eksproprijimi i tillë lejohet me ligj, është i domosdoshëm apo i duhur për arritjen e një qëllimi publik apo për promovim të interesit publik, e i cili pasohet nga sigurimi i kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat personit apo personave, prona e të cilëve është eksproprijuar.

#### ***Ligji mbi eksproprijimin e pronës së patundshme***

Procedura e eksproprijimit të tokës dhe zhvendosjes në Kosovë rregullohet në rend të parë nga *Ligji për eksproprijim të pronës së patundshme nr. 03/L-139* të miratuar në vitin 2009, dhe të ndryshuar me *Ligjin për eksproprijim të pronës së patundshme nr. 03/L-205*. Ligji përcakton procedurën, përfshirë mjetet juridike, për mbrojtje të individëve nga ndërhyrjet joproporcionale në të drejtën në patundshmëri.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup>Sipas Ligjit, prona e patundshme përfshin: (i) tokën, (ii) objektet apo pjesët specifike të objektit të ndërtuar në, mbi apo nën sipërfaqe të tokës (iii) instalime dhe pjesët ndihmëse të cilat janë ngjitur përherë me ndonjë tokë apo objekt e të cilat nuk mundën, pa përpjekje të arsyeshme apo jo-ekonomike, të mënjanohen, dhe (iv) çfarëdo fruta të papjekura që gjenden në tokë të tillë.

**Dispozitat kyçe të këtij ligji relevant për Projektin** mund të përmbliken si në vijim:

- **Interesi publik:** Eksproprijimi mund të kryhet vetëm në rast se përmbushen kushtet vijuese:
  - (i) Eksproprijimi është i lidhur drejtpërsëdrejti me përmbushjen e një interesi legjitim publik;
  - (ii) Interesi legjitim publik nuk mund të realizohet në praktikë pa eksproprijim;
  - (iii) Dobitë publike që nxirren nga eksproprijimi i tejkalojnë interesat e dëmtuara nga ky veprim;
  - (iv) Përzgjedhja e pronës që duhet të eksproprijohet nuk është bërë për ndonjë qëllim apo pikësynim diskriminues, apo për thellimin e tyre; dhe,
  - (v) Autoriteti eksproprijues t'i ketë përmbushur të gjitha dispozitat në fuqi të Ligjit.
- **Inicimi i procedurës së eksproprijimit – kërkesa për eksproprijim:** Procedura mund të iniciohet nga vetë autoriteti eksproprijues apo përmes një kërkesë për eksproprijim të parashtruar autoritetit eksproprijues. Kërkesa përmban informata të domosdoshme lidhur me bartësit e të drejtës pronësore dhe pronat e prekura, të përcjellur me dokumente siç janë shënimet pronësore, plane kadastrale, hapësinore apo urbane si dhe dëshmi se ekzistojnë apo do të vihen mjete të mjaftueshme në dispozicion për pagesën e kompensimit me kohë.  
Pas pranimit të kërkesës, autoriteti eksproprijues shqyrton kërkesën dhe mund ta aprovojë apo ta refuzojë kërkesën, pjesërisht apo tërësisht.  
Në rast të aprovimit, autoriteti eksproprijues e dërgon një kopje të aplikacionit dhe të gjitha dokumenteve të bashkëngjitura në Zyrën për vlerësim të pasurisë së patundshme, dhe njofton bartësit e identifikuar të të drejtave pronësore. Vendimi për aprovim botohet në Gazetën zyrtare, dhe në një gazetë ditore në Kosovë, botimi i të cilit do të përsëritet sërish pas 7 deri në 10 ditë, pasuar nga një periudhë 10 ditore gjatë së cilës palët e interesuara kanë të drejtë të parashtrojnë komente me shkrim autoritetit eksproprijues. Pas publikimit, autoriteti eksproprijues obligohet të mbajë një dëgjim publik në afat prej 15 ditëve në secilën komunë ku gjenden pronat të cilat janë lëndë e eksproprijimit.
- **Vendimi preliminar lidhur me ligjshmërinë e eksproprijimit të propozuar:** Pas shqyrtimit të komenteve me shkrim dhe brengave të shprehura në dëgjime, autoriteti eksproprijues miraton Vendimin preliminar në afat prej 30 ditëve. Autoriteti mund ta refuzojë kërkesën bazuar në komente dhe shqetësime, apo në rast se konstaton se eksproprijimi i propozuar nuk i përmbush kushtet ligjore. Vendimi preliminar botohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetën ditore.
- **Vendimi përfundimtar mbi eksproprijimin:** Autoriteti eksproprijues miraton Vendimin përfundimtar me të cilin miraton apo refuzon kërkesën gjatë një periudhe prej 12 muajve pas hyrjes në fuqi të Vendimit preliminar. Vendimi përfundimtar botohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetën ditore. Vendimi përfundimtar mund të mos miratohet në rast se ka ankesa të pazgjydhura në gjykatë kundër Vendimit preliminar për pronat e prekura.
- **Kompensimi:** Kompensimi rregullohet si nga *Ligji për eksproprijim të pronës së patundshme* ashtu edhe nga *Udhëzimi administrativ për aprovimin e metodave të vlerësimit teknik dhe kriterëve për llogaritje të shumës së kompensimit për pronën e patundshme të eksproprijuar dhe dëmet e ndërlidhura me eksproprijim, nr. 02/2015*, miratuar në vitin 2015 nga Ministria për financa bazuar në *Ligjin*. Sipas *Ligjit*, kompensimi paguhet në bazë të vlerës së tregut të pronës<sup>3</sup>, përfshirë pjesët përcjellëse apo frytet e saj, si dhe për çfarëdo dëme të dëshmueshme direkte të shkaktuar si rezultat e eksproprijimit. Kompensimi paguhet në të gatshme<sup>4</sup>, dhe përfshin shumën e përcaktuar nga Vendimi përfundimtar

<sup>3</sup>Vlera e tregut definohet si: "çmimi të cilin blerësi është i gatshëm të paguaj dhe shitësi të shes pronën e patundshme në një shitblerje zyrtare, ku asnjëri nuk obligohet të veprojë me force dhe se nuk ka marrëdhënie ndërmjet palëve bazuar në gjak, martesë, pronësi të përbashkët apo lidhje biznesore

<sup>4</sup>Kompensimi në naturë përmes shkëmbimit tokë për tokë (ose kombinim të kompensimit në naturë dhe të hollave të gatshme) jepet ekskluzivisht për rastet ku Qeveria është autoritet eksproprijues, dhe ku eksproprijohen më shumë se 20 parcela të pasurisë së patundshme, nëse pajtohen pronarët e pronave të tilla.

**Pragëtrregjionale dhelokale të Kosovës – Vlerësim i mjedisit dhe social**  
Korniza përsigurimit të tokës

plus interesi për shumë të tillë, i cili është akumuluar ndërmjet datës së hyrjes në fuqi të Vendimit përfundimtar dhe datës së pagesës.

Asnjë ndryshim në pronësi apo në të drejta të tjera të personave të prekur zbatohen deri në hyrjen në fuqi të Vendimit përfundimtar, dhe kompensimi i kërkuar nga Vendimi përfundimtar të jetë paguar. Vetëm pasi të jenë përmbytur kushtet e përmendura, prona regjistrohet në emër të komunës.

- **Vlerësimi i pronës:** Zyra për vlerësim të pronës së patundshme për përgjegjëse për vlerësimin e pronës në proces të eksproprijimit, në bazë të *Udhëzimit të lartpërmendur administrativ* i cili rregullon metodologjinë direkte për llogaritje të kompensimit që duhet të paguhet për pronën e eksproprijuar dhe për dëmet e ndërlidhura me eksproprijim. Gjatë procesit të vlerësimit, pronarët dhe bartësit e interesit kanë të drejtë t'i parashtrorjnë Zyrës mendimet e tyre me shkrim lidhur me vlerësimin e tillë dhe të atakojnë vendimet përfundimtare të vlerësimit të Zyrës në gjykatë.
- **Data e prerjes:** *Ligji* shprehimisht parasheh që artikujt në vijim përjashtohen nga shuma e kompensimit:
  - kostoja apo vlera e çfarëdo përmirësimi që i është bërë pronës, stabilimentet e ndërtuara apo të zgjeruara në pronë, apo drunjtë dhe bimët e mbjella në pronë pas datës në të cilën botohet në Gazetë Zyrtare vendimi për pranimin e kërkesës për vazhdim të mëtejme të eksproprijimit (të lëshuar para Vendimit preliminar),
  - Çfarëdo ndryshimesh në vlerën e tregut të pronës e cila është paraqitur ose pas datës së miratimit të vendimit me të cilin autorizohen veprimet përgatitore në pronën e tillë, apo datën e parashtrimit fillestar të kërkesës për eksproprijim, cilado që paraqitet më herët,
  - çfarëdo ndryshimesh të tjera në vlerën e tregut të pronës para inicimit të procedurës së eksproprijimit, nëse dëshmohet se ndryshimet e tilla mund t'i atribuohen manipulimit të çmimit apo të tregut apo spekulimit nga personat (apo nga të afërmit dhe bashkëpunëtorët e tyre) të cilin ishin në dijeni të informatës lidhur me eksproprijimin e afërt apo të mundshëm të pronës.
- **Menaxhimi i ankesave:** Ankesat e parapara me *Ligj* parashihen: (i) ankesat të cilat atakojnë Vendimin preliminar lidhur me Ligjshmërinë e eksproprijimit të propozuar, (ii) ankesat që atakojnë lartësinë e kompensimit, (iii) ankesat për kompensim të dëmeve që dalin nga eksproprijimi i pjesërishtëm; (iv) ankesat që atakojnë ligjshmërinë e Vendimit lidhur me shfrytëzimin e përkohshëm të pronës.

## 2.2 Legjislacioni tjetër i ndërlidhur i Kosovës

Ligjet tjera relevante lidhur me sigurimin e tokës së nevojshme për Projektin janë përmbledhur në Tabelën në vijim.

Tabela 1. Pasqyra e ligjeve relevante për Projektin

LIGJI	PËRMBLEDHJA DHE PIKAT KYÇE
<i>Ligji për pronën dhe të drejtat tjera sendore nr. 03/L-154 i datës 15 korrik 2009</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen dhe ndërprerjen e të drejtave sendore siç janë pronësia, të drejtat e kufizuara sendore, posedimi, të drejtat sendore të sigurisë dhe të drejtat e përdorimit sendor</li> <li>▪ Parasheh se prona dhe të drejtat tjera sendore mund të kufizohen dhe të merren kundër dëshirës së bartësve ligjor vetëm në përputhje me kushtet dhe procedurat e parapara me ligjet në fuqi.</li> </ul>
<i>Ligji nr. 04/L-020 lidhur me ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë nr. 03/L-047 i datës 21 dhjetor 2011</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përcakton komunitetet e Kosovës dhe të drejtat e tyre të veçanta përkatësi me identitetin e tyre, fenë, arsimin, përdorimin e gjuhëve, kulturën, shëndetësinë, mediat, mundësitë ekonomike dhe sociale, si dhe përfaqësimin e tyre politik në të gjitha mekanizmat shtetërorë.</li> <li>▪ Parasheh masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, programet e punësimit publik posaçërisht për bashkësinë e Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve, arsimimin në gjuhën e tyre, etj.</li> </ul>
<i>Ligji për përdorimin e gjuhëve nr. 03/L-37 i datës 31 tetor 2006</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rregullon shfrytëzimin e gjuhëve zyrtare, si dhe gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës dhe në organizatat dhe ndërmarrjet e tyre publike</li> <li>▪ I jep status të barabartë gjuhëve shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare të Kosovës</li> <li>▪ Parasheh të drejtën e të gjitha komuniteteve në Kosovë që të ruajnë, mirëmbajnë dhe promovojnë identitetin e tyre gjuhësor</li> </ul>
<i>Ligji kundër diskriminimit nr. 2004/3 i datës 20 gusht 2004</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Synon të parandalojë dhe luftojë të gjitha format e diskriminimit në sektorët publik dhe privat dhe të promovojë barazi efektive të trajtimit</li> <li>▪ Autorizon organet administrative dhe gjykatat që të vendosin mbi rastet e diskriminimit të pohuar, përfshirë të drejtën e Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë që të pranojë dhe hetojë ankesat bazuar në diskriminim.</li> </ul>
<i>Ligji për barazinë gjinore nr. 2004/2 i datës 7 qershor 2004</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Synon të krijojë kushte dhe mundësi për barazinë gjinore si një vlerë elementare, përmes politikave dhe programeve të cilat mbështesin zhvillimin e përgjithshëm të barabartë dhe pjesëmarrjen e meshkujve dhe femrave në jetën politike, ekonomike, kulturore dhe sociale.</li> </ul>
<i>Ligji për planifikimin hapësinor nr. 04/L-174 i datës 19 gusht 2013</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përcakton parimet bazë të planifikimit hapësinor, metodologjinë e zhvillimit hapësinor dhe rregulloret si dhe përgjegjësitë e organeve administrative në nivel qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve për planifikimin hapësinor.</li> </ul>
<i>Ligji për ndërtimin nr. 04/L-110 i datës 19 qershor 2012</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rregullon procedurën e lëshimit të lejeve ndërtimore, përputhshmërinë me kushtet e lejes ndërtimore, lëshimin e certifikatave për të drejtën e shfrytëzimit, projektimin, ndërtimin, rindërtimin, demolimin, mbikëqyrjen profesionale, inspektimin e ndërtimeve</li> </ul>



### 2.3 Politika në fuqi e BERZH-it

BERZH për këtë projekt aplikon Politikën e vet mjedisore dhe sociale (2014). Sigurimi i tokës, zhvendosja e detyrueshme dhe zhvendosja ekonomike mbulohen nga Kërkesa e performancës (KP) 5 e Politikës. Zbatimi i kësaj KP mbështet dhe është në përputhje me respektimin dhe shqyrtimin universal të të drejtave dhe lirive të njeriut në veçanti të drejtën për banim adekuat si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. **Kërkesat kryesore të KP 5** janë si në vijim:

- Ujditë e negociuara inkurajohen për të shmangur eksproprijimin dhe për të shmangur nevojën e aplikimit të pushtetit qeveritar për të larguar njerëz në mënyrë të detyrueshme;
- Duhet të shqyrtohen të gjitha dizajnet e mundshme alternative të projektit për të shmangur apo së paku minimizuar zhvendosjen fizike dhe/ose ekonomike, krahas baraspeshimit të dobive dhe kostove mjedisore, sociale dhe ekonomike;
- Personat e prekur duhet të konsultohen dhe të përfshihen nga fazat e hershme dhe përmes të gjitha aktiviteteve të zhvendosjes për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të hershme dhe të informuar në proceset e vendim-marrjes të ndërlidhura me zhvendosjen;
- Për secilin projekt, duhet të kryhet vlerësim fillestar socio-ekonomik për njerëzit e prekur nga projekti, përfshirë ndikimet e ndërlidhura me sigurim të jetës dhe kufizim të përdorimit të tokës, si dhe regjistrim të detajshëm të popullsisë;
- Të gjithë personave dhe komuniteteve të zhvendosura duhet t’iu ofrohet kompensim për humbje të aseteve me kosto të plotë të zëvendësimit dhe ndihmën tjetër që ka për synim rikthimin, e mundësisht edhe përmirësimin e standardit të jetës dhe/ose të jetesës në nivelin para zhvendosjes;
- Duhet të themelohet një mekanizëm efektiv i ankimit sa më shpejtë të jetë e mundur në proces në mënyrë që të pranohen dhe të shtjellohen me kohë shqetësimet specifike lidhur me kompensimin dhe zhvendosjen e të cilat paraqiten nga personat e zhvendosur dhe/ose pjesëtarët e komuniteteve pritëse;
- Procesi i zhvendosjes dhe i rikthimit të jetesës do të monitorohet me pjesëmarrjen e hisedarëve kyç, siç janë komunitetet e prekura.

### 2.4 Mangësitë dhe zgjidhjet

Mangësitë dhe zgjidhjet relevante për Projektin e të cilat janë adresuar përmes kësaj KST janë përmbledhur në Tabelën 2 më poshtë.

*Tabela 2. Përmbledhja e mangësive dhe zgjidhjeve relevante për Projektin*

Çështja	Dispozitat e Ligjit mbi eksproprijimin e pronës së patundshme	Kërkesa e BERZH-it	Masa e ndërmarrë për të shtjelluar mangësinë
<b>shmangia apo minimizimi i zhvendosjes</b>	nuk ka dispozita për të shmangur apo minimizuar zhvendosjen	shqyrtimi i të gjitha dizajnet e mundshme alternative të projektit për të shmangur apo së paku minimizuar zhvendosjen fizike dhe/ose ekonomike, krahas baraspeshimit të dobive dhe kostove mjedisore, sociale dhe ekonomike	Projekti do të shqyrtojë rirreshtime të vogla në mënyrë që të shmanget marrja e tokës kudo që është e mundur, në përputhje me Parimet kyçe të sigurimit të tokës/kompensimit të paraparë me këtë KST.
<b>planifikimi dhe zbatimi i zhvendosjes</b>	kërkon vetëm Studim të eksproprijimit si regjistrim fillestar, nuk ka kushte taksative të ndërlidhura me sondazhe socio-ekonomike apo zhvillimin e planeve të zhvendosjes	regjistrimi i popullsisë dhe vlerësimi fillestar socio-ekonomik duhet të kryhen për të identifikuar personat të cilët do të zhvendosen për të përcaktuar se kush i plotëson kushtet për kompensim dhe ndihmë, si dhe përgatitet dhe zbatohet plani i veprimit për	Për Projektin do të zhvillohen Plane të detajshme të sigurimit të tokës (PST) pasi të përcaktohen natyra e saktë dhe përmasat e sigurimit të tokës apo kufizimeve në përdorim të tokës të ndërlidhura me Projektin, gjegjësisht pas hartimit të studimeve të eksproprijimit që

**Drugëtrregjionale dhe lokaletë Kosovës – Vlerësimi mjedisor dhe social**  
Korniza përsigurim të tokës

Çështja	Dispozitat e Ligjit mbi eksproprijimin e pronës së patundshme	Kërkesa e BERZH-it	Masa e ndërmarrë për të shtjelluar mangësinë
		zhvendosje	kërkohen me legjislacion të vendit (deri në prill 2016, sipas vlerësimeve aktuale, krahas zhvillimit të regjistrimit të hollësishëm të popullsisë dhe sondazhit socio-ekonomik).
<b>ujditë e negociuara</b>	nuk obligon apo inkurajon ujdin të negociuara	Inkurajimi i ujdive të negociuara dhe për të ndihmuar në shmangien e eksproprijimit dhe shmangia e domosdoshmërisë së aplikimit të pushtetit qeveritar për të larguar njerëz në mënyrë të detyrueshme	Ujditë e negociuara zbatohen kudo që është e mundur, madje edhe para inicimit të procesit të eksproprijimit në përputhje me Parimet kyçe të marrjes së tokës/kompensimit të parapara me këtë KST.
<b>sigurimi i kompensimit me vlerë zëvendësimi</b>	kompensimi paguhet në bazë të vlerës së tregut të pronës	kompensimi të sigurohet me vlerë të plotë të zëvendësimit, zakonisht i llogaritur si vlerë e tregut të pasurisë plus kostot e transaksionit të ndërlidhura me rikthimin e pasurisë së tillë (taksat e regjistrimit dhe të bartjes)	Njerëzit e prekur nga humbja e përhershme e parcelave të tokës do të pranojnë kompensim me vlerë të plotë të zëvendësimit.
<b>Data e prerjes</b>	përcakton dispozitat mbi datën e prerjes por nuk kërkon që data e tillë të jetë e dokumentuar mirë dhe e shpërndarë në tërë zonën e projektit	Individët që vendosen në zonën e prekur nga projekti pas datës së prerjes nuk kanë të drejtë në kompensim dhe në formë të tjera të ndihmës. Informatat lidhur me datën e prerjes dokumentohen mirë dhe shpërndahen në tërë zonën e projektit.	Data e prerjes shpallset dhe shpërndahet publikisht në media dhe në takime publike me komunitetet e prekura, në përputhje me Parimet kyçe të sigurimit të tokës / kompensimit, të parapara me këtë KST.
<b>individë dhe grupe të cënueshme</b>	nuk ka masa të veçanta për grupet e cënueshme	vëmendje e veçantë t'i kushtohet grupeve të cënueshme	Personat e cënueshëm do të identifikohen dhe masat gjegjëse do të inkorporohen në KST. Qasja në informata dhe ndihmë personave të cënueshëm do të mundësohet nga Ministria, sipas nevojave të tyre specifike, me ndihmë nga shërbimet komunale përgjegjëse për kujdesin social, persona të zhvendosur dhe refugjatë.
<b>mekanizmi i ankesave</b>	pronarët apo bartësit e interesave kanë të drejtë që të parashtrijnë ankesa në fazën e ndryshme të procesit dhe t'i parashtrijnë komente me shkrim autoritetit eksproprijues gjatë procesit të konsultimit, por nuk kërkohet mekanizëm i ankesës specifik për secilin projekt.	duhet të themelohet një mekanizëm efektiv i ankimit sa më shpejtë të jetë e mundur në proces në mënyrë që të pranohen dhe të shtjellohen me kohë shqetësimet specifike lidhur me kompensimin dhe zhvendosjen e të cilat paraqiten nga personat e zhvendosur dhe/ose	Procedura e ankimit është përcaktuar me Planin për përfshirje të hisedarëve (PPH) dhe është përfshirë në këtë KST, dhe do të zbatohet nga Ministria.

**Rrugëtregjionale dhe lokaletë Kosovës – Vlerësimi mjedisor dhe social**  
Korniza përsigurimi të tokës

Çështja	Dispozitat e Ligjit mbi ekspropriimin e pronës së patundshme	Kërkesa e BERZH-it	Masa e ndërmarrë për të shtjelluar mangësinë
		pjesëtarët e komuniteteve pritëse	
<b>monitorimi i zbatimit të zhvendosjes</b>	nuk ka dispozita	aranzhimet për monitorim të zhvendosjes duhet të definohen me planin e zhvendosjes	Monitorimi do të kryhet nga Ministria, ashtu siç përcaktohet me këtë KST.

### 3 Ndikimet e Projektit

Për Projekt parashihet sigurim i përhershëm i tokës për qëllim të ndërtimit të rrugëve të qasjes, rrethrotullimeve dhe mbikalimeve vetëm në komunën e Gjilanit.

Gjatë zhvillimit të kësaj KST, komuna e Gjilanit ka siguruar të dhëna të përkohshme lidhur me përmasat e vlerësuar të sigurimit të tokës, llojit të tokës që do të merret si dhe një listë të pronarëve. Mirëpo, informatat precize lidhur me përmasat e sakta të marrjes së tokës do të sigurohen vetëm pas kryerjes së studimit të eksproprijimit, ashtu siç parashihet me *Ligjin për eksproprijimin e pronës së patundshme*.

Sipas vlerësimeve fillestare, **11 parcela private të tokës do të preken nga marrja e përhershme e tokës** (në pronësi të gjithsej 10 njerëzve<sup>5</sup>). Këto **parcela të tokës kategorizohen si tokë ndërtimore** sipas Planit të rregullativ urban për zonën e cila gjithashtu përfshin rrugën e qasjes në Gjilan. Sipërfaqja e përgjithshme që do të sigurohet është 4142 m<sup>2</sup>.

**Marrja e tokës kryesisht do të prek një pjesë të këtyre parcelave** (prej 11 parcelave të tokës, vetëm 3 do të eksproprijohen në tërësi, ndërsa 8 të mbetura do të eksproprijohen pjesërisht), duke qenë se shiriti ekzistues i magjistrales ofron hapësirë të mjaftueshme për zgjerim. Parcelat e tokës që do të merren janë kryesisht pjesë e parcelave më të mëdha të tokës, të cilat përdoren edhe për qëllime banesore edhe për ato komerciale (objektet e ndërtuara në pjesën tjetër të parcelave – e cila nuk do të eksproprijohet – përfaqëson kryesisht një kombinim të objekteve banesore dhe komerciale, ku katet e poshtme siç janë bodrumet dhe katet përdhese përdoren për destinacione afariste, ndërsa katet e epërme, siç janë katet e para dhe të dyta për qëllime banesore). Mirëpo, nuk priten zhvendosje ekonomike apo humbje të të hyrave apo ndonjë tjetër formë e humbjes, pasi që asnjë pronar i identifikuar nuk do të mbetet pa tokë.

**Nuk priten zhvendosje fizike** pasi që nuk do të merren objekte (legale apo ilegale) në tokën e cila do të merret.

**Parcelat e tokës nuk përdoren për qëllime bujqësore**, dhe nuk do të preken të lashta, pemë apo infrastruktura bujqësore.

Ka gjasa që **do të nevojitet shfrytëzimi i përkohshëm i parcelave private të tokës për qëllime të ndërtimit të rrugëve të qasjes dhe vendosjes së stafit, makinave dhe materialit** gjatë punëve ndërtimore. Parcelat e tilla do të identifikohen pas përfundimit të dizajnit kryesor të Projektit, i cili është në projekt të shqyrtimit nga departamente të ndryshme të Ministrisë dhe nga një kompani e jashtme e dizajnit.

**Nuk është identifikuar ndonjë grup apo persona të veçantë të cenusshëm** gjatë vizitave në terren në zonën e Projektit.

Informatat e hollësishme lidhur me prona dhe njerëz të prekur do të ofrohet në KST pasi të jenë kryer regjistrime të hollësishme të popullsisë dhe sondazhit socio-ekonomik.

#### 3.2 Statusi aktual i Projektit dhe procesi i planifikuar i eksproprijimit

Aktivitetet e eksproprijimit për rrugët e qasjes për Ferizaj dhe Prizren, si dhe për seksionin e rrugës Kllokot – Gjilan janë kryer, ashtu siç tregohet në Tabelën 3. Pjesa më e madhe e eksproprijimit është kryer gjatë periudhës së Jugosllavisë dhe një pjesë e vogël e eksproprijimit në komunën e Prizrenit është kryer në vitin 2012 në përputhje të plotë me Ligjin për eksproprijim. Aktivitetet e sigurimit të tokës në komunën e Gjilanit nuk janë iniciuar ende.

<sup>5</sup>Disa parcela janë në pronësi të pronarëve të shumë, dhe disa pronarë janë në pronësi të më shumë parcelave.



**Rrugëtregjionale dhe lokaletë Kosovës – Vlerësimi mjedisor dhe social**  
Kornizapërsigurim të tokës

Autoriteti përgjegjës për realizimin e procesit të eksproprijimit do të jetë komuna e Gjilanit, ndërsa përfituesi i eksproprijimit do të jetë Ministria si një institucion kyç, përgjegjëse për zbatimin e Projektit. Ashtu siç u shpjegua në seksionet paraprake të kësaj KST, komunat vepronë si autoritet eksproprijues në rastet kur prona e prekur gjendet në tërësi përbrenda kufijve komunal.

Komuna do të iniciojë procedura të eksproprijimit dhe të koordinojë me Zyren për vlerësim të patundshmërive (në kuadër të Departamentit për tatimin në pronë) përbrenda Ministrisë së Financave, organ i vetëm publik ky i cili është kompetent për vlerësimin e patundshmërive që do të jenë lëndë e eksproprijimit. Zyra mund të angazhojë ekspertë të tjerë dhe të themelojë komisione për të inspektuar dhe ndihmuar në vlerësimin e pronës, në bazë të procedurës të ligjshme të prokurimit.

Toka e siguruar do të regjistrohet në emër të komunës, ndërsa Ministrisë do t'i jepet e drejta e shfrytëzimit të parcelave të marra të tokës.

Informatat e dhënë në vazhdim për secilin seksion përfaqësojnë vlerësime bazuar në të dhëna preliminare të siguruara nga komunat e përfshira lidhur me zonat e mundshme të eksproprijimit, pronarët e prekur, etj., dizajnët e detajshme të projekteve për rrugët si dhe në vrojtime nga vizitat në terren të kryera gjatë hartimit të kësaj KST.

*Tabela 3. Statusi i aktiviteteve të eksproprijimit për secilin seksion*

Komuna	Statusi i aktiviteteve të eksproprijimit	Përshkrimi
Komuna e Gjilanit	Nuk është iniciuar ende; fillimi pritet të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2016	Procesi i eksproprijimit nuk është iniciuar ende, dhe studimi i eksproprijimit nuk është zhvilluar. Sipas vlerësimeve fillestare, do të preken 11 parcela të tokës. Nuk pritet ndonjë zhvendosje fizike apo ekonomike. Numri i saktë i parcelave të tokës që do të eksproprijohen do të dihen pas zhvillimit të studimit të eksproprijimit.
Komuna e Ferizajit	Eksproprijimi ka përfunduar	Procesi i eksproprijimit ka përfunduar gjatë periudhës Jugosllave, dhe nuk ka nevojë për sigurimin e tokës shtesë.
Komuna e Prizrenit	Eksproprijimi ka përfunduar	Procesi i eksproprijimit ka përfunduar pjesërisht gjatë periudhës Jugosllave dhe pjesërisht në vitin 2012 nga Qeveria e Kosovës.
Klllokot - Gjilan	Eksproprijimi ka përfunduar	Procesi i eksproprijimit ka përfunduar gjatë periudhës Jugosllave, dhe nuk ka nevojë për sigurimin e tokës shtesë.

## 4 Parimet dhe çështjet kyçe të marrjes së tokës / kompensimit

1. **Marrja e tokës do të bëhet në përputhje me Ligjin për ekspropriimin e pronës së patundshme në Kosovë, Politikën mjedisore dhe sociale të BERZH-it të vitit 2014 si dhe Kërkesave të saj të performancës 5 (Marrja e tokës, zhvendosja e detyrueshme dhe zhvendosja ekonomike), këtë KST dhe me praktikën e mira ndërkombëtare.** Projekti do të shqyrtojë rirreshtime të vogla në mënyrë që të shmanget marrja e tokës kudo që është e mundur.
2. **Të gjithë personat e prekur do të njoftohen dhe të konsultohen** gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Projektit. Të gjithë pronarët, banorët dhe shfrytëzuesit do të vizitohen dhe do t'iu shpjegohet procesi i marrjes së tokës dhe ndikimet specifike në tokën e tyre, ashtu që t'iu jepet mundësia për mikro-rreshtime në mënyrë që të ulen ndikimi dhe vështirësitë e mundshme.
3. **Inkurajimi i ujdive të negociuara** kudo që është e mundur për të ndihmuar në shmangien e ekspropriimit dhe shmangia e domosdoshmërisë së aplikimit të pushtetit qeveritar për të larguar njerëz në mënyrë të detyrueshme.
4. **Hartimi i Planeve të detajshme të sigurimit të tokës (PST) në përputhje me KP 5** për secilën pjesë të Projektit për të cilën kërkohet siguri i tokës, zhvendosja fizike e popullsisë apo humbje e të hyrave për shkak të ndryshimeve në shfrytëzim të tokës apo në qasje në resurse. Secili PST do t'iu nënshtrohet konsultimit publik. Çfarëdo informata/të dhëna për pronat dhe personat e prekur të dhënë në PST do të trajtohen si informata konfidenciale dhe nuk do të shpalosen publikisht nga Ministria, komuna dhe/ose nga BERZH-i<sup>6</sup>. PST do të bazohen në informata të besueshme dhe azhure dhe do të përfshijnë informata elementare lidhur me Projektin, ndikimet e Projektit, njerëzit dhe pasurinë e prekur, të drejtat për të gjitha kategoritë e njerëzve të prekur si dhe bazën ligjore lidhur me zhvendosjen apo çfarëdo dallime ndërmjet legjislacionit të Kosovës dhe KP 5. Secili PST gjithashtu përmban buxhet dhe orar të detajshëm. **Sondazhi fillestar socio-ekonomik dhe regjistrimi i popullsisë** për secilin PST do të identifikojë si shfrytëzues formal të tokës/pasurisë ashtu edhe ata joformal, përfshirë persona/amvisëri të cenueshëm, siç janë nëna të vetme, të veja dhe të ve, njerëz me aftësi të kufizuara, apo ata që jetojnë në varfëri të skajshme.
5. **Data e prerjes** për krijimin e të drejtës (si për pronarë/shfrytëzues formal ashtu edhe për ata joformal) **do të jetë data në të cilën botohet vendimi për pranimin e kërkesës për procedim të mëtejshëm të ekspropriimit (e lëshuar para Vendimit preliminar) në Gazetën Zyrtare.** Personat që janë vendosur në zonën e Projektit pas datës së prerjes nuk do të kenë të drejtë në çfarëdo kompensimi. Data e prerjes do të shpaloset dhe të shpërndahet publikisht në media dhe në takime publike në komunitetet e prekura.  
Në përputhje me *Ligjin mbi ekspropriimin e pronës së patundshme*, artikujt vijues përjashtohen nga shumica e kompensimit:
  - kostoja apo vlera e çfarëdo përmirësimi që i është bërë pronës, stabilimentet e ndërtuara apo të zgjeruara në pronë, apo drunjtë dhe bimët e mbjella në pronë pas datës në të cilën botohet në Gazetë Zyrtare vendimi për pranimin e kërkesës për vazhdim të mëtejshëm të ekspropriimit (të lëshuar para Vendimit preliminar),
  - Çfarëdo ndryshimesh në vlerën e tregut të pronës e cila është paraqitur ose pas datës së miratimit të vendimit me të cilin autorizohen veprimet përgatitore në pronën e tillë, apo datën e parashtrimit fillestar të kërkesës për ekspropriim, cilado që paraqitet më herët,

<sup>6</sup>KST të cilat përmbajnë informata/të dhëna konfidenciale do të shenjëzohen me "vetëm për përdorim të brendshëm", ndërsa versioni tjetër i KST i quajtur "versioni publik" do të zhvillohet pa informata/të dhëna të tilla.

**Rrugëtregjionale dhe lokaletë Kosovës – Vlerësimi mjedisor dhe social**  
Korniza përsigurimit të tokës

- dhe çfarëdo ndryshimesh të tjera në vlerën e tregut të pronës para inicimit të procedurës së ekspropriimit, nëse dëshmohet se ndryshimet e tilla mund t'i atribuohen manipulimit të çmimit apo të tregut apo spekulimit nga personat (apo nga të afërmit dhe bashkëpunëtorët e tyre) të cilin ishin në dijeni të informatës lidhur me ekspropriimin e afërt apo të mundshëm të pronës.

6. **Të gjithë pronarët, banuesit apo shfrytëzuesit** e tokës së prekur në kohën e datës së prerjes, me ose pa të drejta të plota të pranuar të pronësisë, **i plotësojnë kushtet për kompensim dhe/ose ndihmë**, ashtu siç parashihet me Matricën e të drejtave (Tabela 4 e këtij dokumenti).
7. **Zënia e përkohshme e tokës për qëllime të ndërtimit do të kompensohet** në përputhje me *Ligjin për ekspropriim të pronës së patundshme*, ashtu siç parashihet me Matricën e të drejtave (Tabela 4 e këtij dokumenti).
8. **Standardi i jetës dhe/ose i jetesës së njerëzve të prekur do të rivendoset, e mundësisht edhe të përmirësohet** në afat sa më të shkurtër.
9. **Vlerësimi zyrtar i pasurive/përmirësimeve në tokë kryhet nga vlerësues të certifikuar nga Zyra për vlerësim të pronës së patundshme** (Departamenti i tatimit në pronë përbrenda Ministrisë së Financave) apo nga vlerësues të certifikuar në bazë të procedurës së prokurimit publik.
10. Kompensimi do të ofrohet para marrjes së tokës. Çështjet e ndërlidhura me **pagesën e kompensimit me të gatshme do të diskutohen dhe të dakordohen me të gjithë pjesëtarët** e amvisërive të prekura. Kompensimi në të gatshme do të paguhet në tërësi në llogaritë bankare të përcaktuara nga pronarë, në marrëveshje me të gjithë pjesëtarët e prekur të amvisërive. Në rastet kur ka më shumë se një pronar i vetëm (gjegjësisht, bashkëpronësi nga çiftet e martuara), shumën e kompensimit do të ndahet dhe të paguhet në llogari bankare të cilat ata i përcaktojnë.
11. **Personave dhe komuniteteve të prekura nga Projekti do t'u sigurohen informata dhe konsulta** në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e hershme dhe e informuar e tyre në procesin e vendim-marrjes të ndërlidhur me sigurimin e tokës. **Qasja në informata dhe ndihmë për personat/amvisëritë e cenusëshëm do të lehtësohen nga komuna** varësisht prej nevojave të tyre specifike, në bazë të shqyrtimit rast për rast të kryer me ndihmën e Zyrës për vlerësim të pasurisë së patundshme (përbrenda Ministrisë së financave) dhe departamentet përkatëse sociale të Komunës.<sup>7</sup>
12. Themelohet mekanizëm efektiv i ankimit për pranimin dhe shqyrtimin e shqetësimeve specifike me kohë përkitazi me kompensimin dhe zhvendosjen, të parashtruar nga personat e zhvendosur.
13. Ministria do të **monitorojë zbatimin e procesit të sigurimit të tokës**, si përmes aranzhimeve të brendshme, zyrtare institucionale ashtu edhe përmes një mbikëqyrësi të pavarur, të jashtëm. Ministria gjithashtu do të inkurajojë institucionet tjera, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të vendore që të kyçen në procesin e monitorimit.

---

<sup>7</sup>Lista indikativë e aktiviteteve përfshin: takimet individuale për të shpjeguar kriteret e pranueshmërisë dhe të drejtat që u takojnë, procesin e pagesave (gjegjësisht, duke u kujdesur që dokumentet e kompensimit dhe procesi i pagesave të kuptohen si duhet), ndihmë në periudhën pas pagesës për të siguruar të hollat e kompensimit dhe për të ulur rreziqet nga keqëpërdorimi apo plaçkitje.

## 5 Të drejtat në kompensim

Të drejtat në kompensim për kategoritë e ndryshme të personave dhe pasurive që i përmbushin kushtet përmbledhen më poshtë në Tabelën 4.

Tabela 4. Të drejtat specifike të kompensimit

Lloji i të drejtës, pronës së prekur nga Projekti apo i humbjes	Korniza ligjore / e politikave në fuqi	E drejta	Kushtet e procesit dhe ato specifike
<b>Humbje e përhershme e truallit për ndërtim</b>	Ligji mbi eksproprijimin e pronës së patundshme  Politika e BERZH	Kompensimi i truallit në të gatshme me vlerë të zëvendësimit	Ofrimi i kompensimit me vlerë të zëvendësimit të kryhet në përputhje me politikën e BERZH
<b>Zënia e përkohshme e tokës dhe dëmtimi</b>	Ligji mbi eksproprijimin e pronës së patundshme	Toka dhe infrastruktura e prekur të rikthehet në gjendjen para projektit + Kompensimi në të gatshme për zënie e përkohshme të tokës në shumën e normës mesatare të qirasë për pronë të patundshme me karakteristika të njëjta apo të ngjashme në lagje + Kompensimi për dëmet të tjera në pronë	Zënia e përkohshme e tokës dhe çfarëdo dëme dhe pasuri kompensohen në përputhje me Ligjin për eksproprijim të pronës së patundshme.



## 6 Shpallja e informatave dhe konsultimet publike

Kërkesat për shpallje të informatave relevante për Projektin dhe për konsultimet publike janë paraparë në Planin për përfshirje të hisedarëve (PPH) përgatitur nga Ministria me qëllim të përmirësimit të përfshirjes së hisedarëve gjatë tërë ciklit jetësor të Projektit, dhe për realizimin e përfshirjes së hisedarëve në përputhje me legjislacionin lokal dhe me kërkesat e BERZH.

Njësia për zbatim të projektit (NJZP) pranë Ministrisë do të jetë përgjegjëse për të komunikuar me komunat, bashkësitë e prekura lokale dhe me PAP NJZP, së bashku me komunat e përfshira, kryejnë konsultime publike dhe shpërndarje të informatave të cilat do të pasqyrojnë çështjet kryesore me rëndësi për Projektin. Të gjithë hisedarët e interesuar do të informohen me kohë lidhur me fushëveprimin e Projektit dhe kontaktet për të kërkuar informata të tjera, si dhe për disponueshmërinë e dokumenteve të Projektit, përmes ueb faqes së Ministrisë dhe komunave të prekura, si dhe përmes njoftimeve në mediat lokale ditore (gazetat, TV apo radio). Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit adekuat të gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Amvisëritë dhe bizneset e prekura qartazi nga marrja e tokës dhe zënia e përkohshme e tokës do të vizitohen dhe të njoftohen individualisht lidhur me ndikimet e Projektit në pronën e tyre, në veçanti trasën e saktë të rrugës në raport me secilën parcelë. Qasja në informata për grupet e cënueshme do të mundësohet nga NJZP, sipas nevojës për secilin person / amvisëri varësisht prej nevojave dhe / ose situatës së tyre specifike, në bashkëpunim me departamentet komunale për çështje sociale.

Ministria, së bashku me komunat relevante, do të caktojë dhe të mbajnë takime të rregullta për përfaqësues të grupeve të ndryshme të hisedarëve, si në vijim:

- **takimet publike konsultative** parashihet të mbahen së paku një herë para fillimit të punëve ndërtimore, dhe së paku njëherë gjatë punëve ndërtimore. Takimet e tilla kanë për synim të ofrojnë vend-tubim të rregullt të gjithë hisedarëve dhe janë të hapura për të gjitha palët e interesuara. Gjatë këtyre takimeve, Ministria do të prezantojë gjurmët e Projektit, ndikimet e pritua dhe masat e planifikuara të zbutjes. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të prezantojnë mendimet dhe vërejtjet e tyre lidhur me Projektin, si dhe të sugjerojnë zgjidhje të mundshme të çështjeve të parashtruara, të cilat do të dokumentohen dhe të adresohen si duhet në raportet për monitorim të ankesave dhe veprimeve pasuese të ndërmarrë nga Ministria. Nëse është e nevojshme, mbahen takime të ndara për t'u siguruar se përfshirja e hisedarëve është e përgjegjshme nga aspekti gjinor.
- **Takimet konsultative me komunitetin lokal** synojnë të përfshijnë individët, amvisëritë dhe bizneset e prekura nga aktivitetet ndërtimore në procesin e konsultimit, dhe do të organizohen në komunitetin lokal sipas nevojës.
- **Takimet individuale konsultative** synojnë të angazhojnë grupe individuale të hisedarëve lidhur me çështje specifike dhe do të organizohen sipas nevojës. Kësi lloj takimesh mund të iniciohen nga Ministria, apo nga cilido grup i identifikuar i hisedarëve.
- **Dëgjimet publike** do të mbahen sipas nevojës edhe nga legjislatura lokale për të konsultuar publikun lidhur me përmbajtjen e VNM dhe sigurimit të tokës dhe dokumenteve të tjera, ashtu siç përshkruhet në pjesët e mësipërme të dokumentit.

Takimi i parë publik konsultativ do të organizohet gjatë fazës së tenderit dhe pas kontraktimit të Konsulentit për bashkëpunim teknik për të mbështetur NJZP. Orari kohor dhe vendi i caktuar për takime publike konsultative do të definohet në mënyrë precize nga Ministria pas përcaktimit të datës së fillimit të Projektit. Takimi i parë publik do të organizohet në afat prej një muaji pas datës zyrtare të fillimit të Projektit. Të gjithë hisedarët do të njoftohen për datën, kohën dhe vendin e saktë ku do të mbahet takimi

**Rrugëtregjionale dhe lokaletë Kosovës – Vlerësimi mjedisor dhe social**  
Kornizë për sigurim të tokës

konsultativ së paku 7 ditë më herët, përmes shpalosjes në ueb faqet e Ministrisë dhe të komunave të përfshira, si dhe gazetave ditore/radio dhe TV stacioneve.

**Të gjitha informatat për Projektin të cilat do t'i vihen në dispozicion publikut, dhe të parapara me PPH do t'i shpalosen publikut para takimit të parë publik.**

**Ministria do të shpalos dokumentacion dhe informata vijuese lidhur me Projektin:**

- Këtë Kornizë për sigurim të tokës (KST);
- Përshkrimin e projektit dhe azhurnimet lidhur me përparimin e zbatimit të Projektit;
- Informatat lidhur me shëndetin e komunitetit dhe rreziqet dhe ndikimet në siguri (përfshirë kufizimet e pritura në rrugën për qasje dhe punët ndërtimore) si dhe masat e propozuara të zbutjes;
- Plani për përfshirje të hisedarëve (PPH);
- Përmbledhja jo-teknike (PJT) e Projektit;
- Përmbledhje e konkluzioneve nga takimet konsultative dhe diskutimet e mbajtura publike;
- Formulari i ankesës dhe formulari për kërkim të informatave.

**Dokumentet do të vihen në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe (si dhe në atë angleze, aty ku ka) menjëherë pas fillimit të Projektit në ueb faqet e Ministrisë dhe komunave të përfshira, si dhe në kopje të printuara në lokalet e komunës në adresën:**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS

Adresa: Ish Ndërtesa e Gërmisë,

10000, Prishtinë,

Republika e Kosovës

Këto dokumente dhe informata mbesin në domenin publik gjatë tërë kohëzgjatjes së Projektit.

## 7 Zbatimi i KST

### 7.1 Përgjegjësitë për zbatim

Të gjitha palët e përfshira në Projekt, përfshirë Ministrinë e infrastrukturës, Ministrinë e financave (gjegjësisht, Zyren për vlerësim të pronës<sup>8</sup>), komunat relevante dhe kontraktuesin i cili do të angazhohet nga Ministria e infrastrukturës për të punuar në lokacione të Projektit, duhet të zbatojnë dispozitat e kësaj KST.

Përgjegjësitë do të ndahen ndërmjet Ministrisë së infrastrukturës, Ministrisë së financave, komunave, Kontraktuesit dhe agjencive të tjera, në përputhje me Tabelën 5 në vijim:

*Tabela 5: Përgjegjësitë dhe aranzhimet organizative*

Detyra	Subjekti përgjegjës
Shpalosja e informatave për të gjithë njerëzit dhe komunitetet e prekur nga Projekti	Ministria e infrastrukturës / komunat
Vlerësimi i pronës	Ministria e financave (Zyra për vlerësim të pronës)
Komunikimi direkt dhe vizitat pronarëve / banuesve	Ministria si përfituese e eksproprijimit dhe komunat e përfshira si autoritete të eksproprijimit
Negociatat dhe aktivitetet e eksproprijimit, para fillimit të ndërtimit	Ministria e infrastrukturës / komunat
Sigurimi i ndihmës për personat / amvisëritë e cenushme	Ministria e infrastrukturës në bashkëpunim me departamentet komunale përgjegjëse për kujdesin social, persona të zhvendosur dhe refugjatë, si dhe ministri të tjera
Pagesat / ofrimi i pakove të kompensimit	Ministria e Infrastrukturës
Monitorimi dhe raportimi në lidhje me eksproprijimin	Ministria e Infrastrukturës
Monitorimi dhe raportimi përkitazi me shfrytëzimin e përkohshëm të tokës i kryer pas fillimit të ndërtimit	Kontraktuesi
Menaxhimi i ankesave	Ministria e Infrastrukturës / kontraktuesi

### 7.2 Kostot

Shpenzimet e sigurimit të tokës barten nga Ministria për infrastrukturë si përfituese e eksproprijimit. Buxheti për sigurim të tokës do të përgatitet pasi të jetë zhvilluar studimi për eksproprijim në përputhje me *Ligjin për eksproprijim të pronës së patundshme* dhe pasi të definohen kostot e përafërta.

### 7.3 Monitorimi dhe raportimi

Njësia e Ministrisë për zbatim të Projektit do të jetë përgjegjëse për monitorim, mirëmbajtje dhe azhurnim të rregullt të bazës së të dhënave për sigurim të tokës lidhur me pronarët / shfrytëzuesit e pasurive të prekura.

Ministria do të përgatisë dhe të parashtojë Raporte vjetore mjedisore dhe sociale BERZH-it përfshirë progresin e arritur në zbatimin e kësaj KST. Përmbledhja e këtyre raporteve do të botohen në ueb faqen e Ministrisë. Gjithashtu, Ministria do të mundësojë realizimin e një Auditimi të përfundimit në fund të procesit të sigurimit të tokës nga një ekspert i pavarur.

Treguesit që duhet të përdoren për monitorim përfshijnë, në veçanti, këto në vijim:

<sup>8</sup>Zyra për vlerësim të patundshmërive (në kuadër të Departamentit për tatimin në pronë) përbrenda Ministrisë së Financave, organ i vetëm publik ky i cili është kompetent për vlerësimin e patundshmërive që do të jenë lëndë e eksproprijimit.

**Rrugëtregjionale dhe lokaletë Kosovës – Vlerësimi mjedisor dhe social**  
Korniza përsigurimi të tokës

- Shpenzimi i përgjithshëm për eksproprijim dhe kompensim
- Numri i njerëzve të prekur nga Projekti sipas kategorive
- Numri i takimeve dhe konsultimeve me njerëzit e prekur
- Numri dhe përqindja e marrëveshjeve individuale të kompensimit të nënshkruara para fillimit të aktiviteteve ndërtimore
- Numri i personave që kërkojnë ndihmë speciale dhe llojet e ndihmave që iu ofrohen individëve / amvisërive të cënueshëm me kohë
- Numri i njerëzve që kanë pranuar kompensim në të gatshme në periudhën me shpërndarjen sipas llojit të kompensimit dhe klasave të shumave
- Numri dhe shuma e pagesave të cilat rikthejnë humbjen e të hyrave (nëse ka të tilla)
- Numri dhe lloji i ankesave, përfshirë çfarëdo raste në gjykata, të ndërlidhura me sigurimin e tokës (parashtruar dhe zgjidhur dhe kohëzgjatja e nevojshme për zgjidhjen e tyre)



## 8 Mekanizmi i ankesave

Ministria do të themelojë një regjistër të ankesave. Çfarëdo komente apo shqetësime mund t'i parashtrohet Ministrisë ose Kontraktuesit verbalisht apo me shkrim (me postë apo email) apo duke mbushur formularin e ankesës (shih Shtojcën 3), pa asnjë kosto për ankuesin. Të gjitha ankesat do të regjistrohen në regjistër dhe do t'iu caktohet një numër, si dhe të vërtetohen në afat prej 7 ditëve kalendarike. Secila ankesë do të regjistrohet në regjistër me informata vijuese:

- përshkrimin e ankesës,
- datën e vërtetimit të pranimit i cili i kthehet parashtruesit të ankesës,
- përshkrimi i veprimeve të ndërmarra (hetimet, masa korigjuese), dhe
- data e zgjidhjes dhe mbylljes / dhënia e reagimeve parashtruesit të ankesave.

Ministria do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të shqyrtuar ankesën pas pranimit të saj. Nëse Ministria nuk është në gjendje të shtjellojë çështjen e parashtruar me veprime të menjëhershme korigjuese, do të identifikohet veprimi afatgjatë korigjues. Parashtruesi i kërkesës njoftohet lidhur me masën e propozuar korigjuese dhe masat pasuese korigjuese në afat prej 30 ditëve kalendarike për vërtetimit të pranimit të ankesës.

Nëse Ministria nuk është në gjendje të zgjidh një çështje të caktuar përmes mekanizmit të ankesave apo nëse veprimi nuk është i nevojshëm, ajo jep sqarime / arsyetime të hollësishme lidhur me atë se pse çështja nuk është shtjelluar. Përgjigja gjithashtu përmban një shpjegim se si personi/organizata e cila e ka parashtruar ankesën mund të vazhdojnë tutje në procedurë ankimi nëse rezultati nuk është i kënaqshëm.

Gjatë gjithë kohës, parashtruesi i ankesës mund të kërkojë mjete të tjera ligjore në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës.

Për punëtorët ekziston mekanizëm i veçantë i ankimit.

### **Kontakt informata për pyetje dhe ankesa:**

Për: Kreun e NJZP – z. Ramë Qupeva,  
Ministria e Infrastrukturës  
Adresa: Ish Ndërtesa e Gërmisë,  
10000, Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Email: mi.info@rks-gov.net  
Tel/fax: +381 (0)38 211 494  
Tel.: +381 (0)38 200 28 lok. 505

### **Informatat kontaktuese për pyetje:**

Zyra për informim publik brenda Ministrisë së infrastrukturës  
Tel/fax: +381 (0)38 200 28 lok. 507  
Tel/fax: +381 (0)38 200 28 lok. 041  
Tel/fax: +381 (0)38 200 28 lok. 048

## Shtojca 1: Mostra e kornizës për KST

### ▪ HYRJE DHE PËRSHKRIM TË PROJEKTIT

Të jepet një përshkrim dhe konteksti i **projektit**, të përshkruhen komponentet e projektit për të cilat nevojitet sigurimi i tokës dhe zhvendosja, të përcaktohen **pikësynimet dhe fushëveprimi i KST**; të sigurohen informata lidhur me **statusin aktual të Projektit** si dhe **procesin e planifikuar të sigurimit të tokës**.

### ▪ KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE / ANALIZA E MANGËSIVE

Të përshkruhen të **gjitha ligjet dhe rregulloret relevante lokale** të cilat vlejné për zhvendosje, përshkruani **kushtet e BERZH**; të identifikohen **boshllëqe** ndërmjet legjislacionit lokal dhe politikave të BERZH, dhe përshkruani **mekanizma** specifike për Projektin për të **adresuar boshllëqet e tilla**.

### ▪ NDIKIMET E PROJEKTIT

Të identifikohen të gjitha **kategoritë e ndikimeve dhe njerëzit e prekur**; të ofrohen **rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe sondazheve socio-ekonomike**.

### ▪ KOMPENSIMI DHE TË DREJTAT

Të definojnë të **drejtat e të gjitha kategorive të personave të prekur** (përfshirë komunitetet pritëse), ku vëmendje e veçantë i kushtohet nevojave të të cenuarve; të jepet **matrica e të drejtave** me të cilën propozohet kompensim dhe ndihmë për kategoritë e ndryshme të ndikimeve përfshirë ndihmë dhe mbështetje atyre që nuk janë bartës të titullit dhe ndihmë meshkujve dhe femrave të cenueshëm, sipas nevojës; të inkorporohen masat për të siguruar ndihmë ligjore personave të zhvendosur për t'iu mundësuar që t'i përmbushin kërkesat administrative para sigurimit të tokës dhe, nëse është e nevojshme, të parashtrajnë ankesa në gjykata; të përshkruhen **procedurat organizative për ofrimin e të drejtave**.

### ▪ SHPALOSJA E INFORMATAVE DHE KONSULTIMET PUBLIKE

Të përshkruhen **mekanizma për konsultime** me njerëzit e prekur nga projekti, dhe pjesëmarrjen e të zhvendosurve meshkuj dhe femra në planifikim, zbatim dhe monitorim; të përshkruhen edhe shpalosja e informatave edhe konsultimet e mbajtura deri në atë datë si dhe shpalosja e planifikuar e informatave dhe konsultimet.

### ▪ ZBATIMI I KST – ORARI, KOSTOT DHE PËRGJEGJËSITË

Të përcaktohen **përgjegjësitë për zbatim** përfshirë identifikimin e agjencive përgjegjëse për secilin aktivitet dhe me shpjegim të shkurtër të secilit aktivitet dhe orarit të planifikuar; të definojnë **kostoja dhe buxheti** (burimet e financimit për zhvendosje, kostot e financimit dhe buxheti i vlerësuar sipas kostos dhe zërit); të përcaktohen kushtet për **monitorim dhe raportim** në lidhje me sigurimin e tokës dhe zhvendosjen dhe marrja e masave korrigjuese sipas nevojës (procedurat për monitorim dhe vlerësim, treguesit kyç të monitorimit, shpeshtësia e raportimit).

### ▪ MENAXHIMI I ANKESAVE


Të përshkruhet hap pas hapi **procesi për regjistrimin dhe shtjellimin e ankesave** dhe të ofrohen detaje specifike lidhur me procesin pa pagesë për regjistrim të ankesave, kohën e përgjigjes, si dhe mënyrat e komunikimit; të përshkruhet mekanizmi për ankesa.

### ▪ ANEKSET

Anekset mund të përfshijnë:

- Listën e parcelave të prekura, hartat, etj.
- Kopjet e instrumenteve të regjistrimit të popullsisë dhe sondazhit dhe mjetet tjera të hulumtimit
- Informatat mbi të gjitha konsultimet publike përfshirë shpalljet dhe oraret e takimeve publike, procesverbalet dhe listat e pjesëmarrësve

## Shtojca 2: Grafiku i rrjedhës për procedimin e ankesave



## Shtojca 3: Formulari i ankesës publike

Numri referues:	
Emri i plotë (fakultativ)	
Informatat për kontakt  Luteni të tregoni se si dëshironi t'ju kontaktojnë (mail, telefoni, email).	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Me postë: Luteni të ofroni adresë postare: _____</li> <li>_____</li> <li>_____</li> <li>▪ By Telephone: _____</li> <li>▪ By E-mail _____</li> </ul>
Gjuha e parapëlqyer e komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Gjuha shqipe</li> <li>▪ Gjuha serbe</li> <li>▪ Gjuha angleze (nëse është e mundur)</li> </ul>
<b>Përshkrimi i incidentit për ankesë</b>	
Përshkrimi i incidentit për ankesë	Çka ndodhi? Ku ndodhi? Kujt i ndodhi? Çka është rezultat i këtij problemi?
Data e incidentit / ankesës	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Incident / ankesë njëherëshe (data _____)</li> <li>▪ Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? _____)</li> <li>▪ Në vazhdim e sipër (aktualisht e vuaj problemin)</li> </ul>
<b>Çka do të donit të bëhej?</b>	
Çka do të donit të bëhej?	

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_  
Data: \_\_\_\_\_

**Luteni që ta ktheni këtë formular tek  
NJËSITI PËR ZBATIM TË PROJEKTIT – MINISTRIA PËR INFRASTRUKTURË**

Z. Ramë Qupeva  
Adresa: Ish objekti i Gërmisë, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës  
Email: mi.info@rks-gov.net  
Tel/fax: +381 (0) 38 211 494, Tel.: +381 (0) 38 200 28 lok. 505